

KPA largon nga sistemi i drejtësisë gjyqtaren Regleta Panajoti

Pas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren Regleta Panajoti, bazuar në dorëheqjen e saj, Kolegji i Posaçëm i Apelit vendosi të prishë vendimin e Komisionit për konfirmimin e saj në detyrë dhe ndërpreu procesin e rivlerësimit.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Rivlerësimi i gjyqtares Regleta Panajoti, e cila mungoi në seancë | Foto : Vladimir Karaj

Kolegji i Posaçëm i Apelit, KPA vendosi të enjten që të ndërpresë procesin e rivlerësimit për gjyqtaren e gjykatës së Tiranës, Regleta Panajoti si dhe t'i heqë të drejtën për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë për 15 vitet e ardhshme. Gjithashtu, Kolegji vendosi edhe ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, KPK që e konfirmoi me shumicë votash në detyrë Panajotin.

Regleta Panajoti kërkoi dorëheqjen nga detyra pas ankimit të kryer nga Komisioneri Publik Florian Ballhysa, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk e justifikon pasurinë dhe se nuk ka bërë deklaram të mjaftueshëm në këtë kriter.

Kryesuesi i trupit gjykues të KPA, Ardian Hajdari shpjegoi në fillim të seancës publike të enjten se ishte konfirmuar prej Këshillit të Lartë Gjyqësor, KLGJ-së, se gjyqtares Panajoti i ishte njoftuar vendimi për mbarimin e statusit sipas ligjit, në adresën e saj postare; pranë vendit ku ushtron detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; në adresën elektronike, si dhe është publikuar në faqen zyrtare. Gjithashtu, KLGJ ka njoftuar se në rastin konkret ka përfunduar afati i ankimit.

Bazuar në kërkesën e KPA, Gjykata administrative e Apelit ka njoftuar se deri më datë 28 korrik, ora 16:00 nuk është depozituar asnjë ankim kundër vendimit të KLGJ për deklarimin e përfundimit të statusit të magjistratit për gjyqtaren Regleta Panajoti.

Kryesuesi Hajdari shtoi se Panajoti kishte konfirmuar nëpërmjet një email-i marrjen në dijeni të vendimit të KLGJ për mbarimin e statusit të magjistratit dhe se vullneti i saj kishte qenë dhe mbetej dorëheqja, si dhe kërkonte ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

Pasi Kolegji i kërkoi Komisionerit Publik Florian Ballhysa që të jepte qëndrimin e tij lidhur me mundësinë e çeljes së hetimit gjyqësor, ai u shpreh se nuk ishte njohur me gjithë dokumentacionin e korrespondencës së KPA-së me institucionet.

Ballhysa tha se bazuar në dokumentacionin që dispononte vërehej se njoftimi i kryer prej Gjykatës së Tiranës ishte i pavlefshëm pasi nuk i përmbante të dhënat që kërkon ligji. “Nuk kuptohet se kujt i është njoftuar vendimi i KLGJ, ndërkohë që subjekti nuk ka qenë në punë në atë periudhë, pasi është larguar”, pohoi Komisioneri.

Gjithashtu, ai vërejtë se përgjigja që Panajoti i kishte kthyer KPA në postën elektronike, nuk ishte në funksion të kërkesës për shprehjen e vullnetit të saj lidhur me procesin, por në përgjigje të njoftimit për ndryshimin e një anëtari të trupit gjykues.

Ballhysa deklaroi se sipas dokumentacionit nuk rezultonte që Panajoti të ishte njoftuar dhe se duhej të konfirmohej marrja dijeni e saj për vendimin e KLGJ për përfundimin e statusit të magjistratit. Në fund ai u shpreh se kërkesat për të verifikuar marrjen në dijeni të Panajotit për vendimin ishin kryer nga vetë Kolegji dhe se e linte në çmim të këtij të fundit vazhdimësinë e procesit.

Kolegji vlerësoi se për shkak të dorëheqjes së saj si dhe vendimit të KLGJ, Panajoti e ka humbur statusin ex officio dhe për këtë arsye nuk mund të vazhdojë procesi i rivlerësimit. Në përfundim, trupi gjykues vendosi prishjen e vendimit të KPK për konfirmimin në detyrë të gjyqtares Regleta Panajoti; ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe heqjen e të drejtës për t’u emëruar në institucionet e drejtësisë gjatë 15 viteve të ardhshme.

Gjyqtarja Regleta Panajoti, ish-kandidate për një pozicion në Gjykatën Kushtetuese u konfirmua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, KPK me shumicë votash më 26 qershor 2019. Pro konfirmimit të saj votuan Genta Tafa Bungo dhe anëtarja Valbona Sanxhaktari. Ndërsa komisioneri Lulzim Hamitaj argumentoi në mendimin e pakicës se “subjekti kishte mungesë prej 3.8 milionë lekësh” dhe duhej shkarkuar për deklarim të pamjaftueshëm. Vendimi i KPK u ankimua nga Komisioneri Publik që kërkoi shkarkimin e gjyqtares Panajoti.

Në prag të fillimit të procesit të rivlerësimit në KPA, Panajoti paraqiti dorëheqjen në KLGJ që vendosi përfundimin e statusit të magjistratit.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.